



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 252 Akti

Nr.215 Vendimi
Tiranë, më 4.12.2019

V E N D I M

Trupit gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Pamela Qirko	Kryesuese
Xhensila Pine	Relatore
Etleđa Çiftja	Anëtare

në praninë edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier de Mongeot, asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Etmonda Hoxha, në datën 2 dhjetor 2019, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0, Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:

Znj. Iliriana Olldashi, gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar Tiranë.

OBJEKTI:

Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE:

Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet Ç, D, DH, E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, dëgjoi subjektin e rivlerësimit, znj. Iliriana Olldashi, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

1. Znj. Iliriana Olldashi është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit të saj në kohën e hyrjes në fuqi të ligjit si gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda Tiranë, bazuar në nenin 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

2. Bazuar në nenin 14, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, duke u shortuar në datën 15.5.2018 me trupin gjykues, të përbërë nga komisioneret Pamela Qirko, Xhensila Pine dhe Etleda Çiftja.
3. Menjëherë pas hedhjes së shortit u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), sipas neneve 31 - 33, të ligjit nr. 84/2016; Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK), sipas neneve 34 - 39, të ligjit nr. 84/2016; dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ), sipas ligjit nr. 84/2016.
4. Trupi gjykues, me vendimin nr. 1, datë 17.5.2018, pas studimit të raporteve të sipërpërmendura të vlerësimit, të hartuara nga institucionet shtetërore, vendosi të fillojë hetimin administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, sipas nenit 45, të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit dhe të caktojë kryesues të trupit gjykues, komisioneren Pamela Qirko. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.
5. Bazuar në pikën 1, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues, pas hetimit të kryer, vendosi në datën 8.11.2019: (i) të përfundojë hetimin paraprak për subjektin e rivlerësimit, znj. Iliriana Olldashi, bazuar në relativimin mbi rezultatet e hetimit të paraqitur nga relatorja e çështjes; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit, znj. Iliriana Olldashi, se i ka kaluar barra e provës mbi rezultatet e hetimit, referuar nenit 52, të ligjit nr. 84/2016; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit, znj. Iliriana Olldashi, për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47, të ligjit nr. 84/2016, dhe me nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative; (iv) të njoftojë subjektin e rivlerësimit, znj. Iliriana Olldashi, mbi të drejtat në lidhje me deklarinimin e konfliktit të interesit, me të drejtën për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit, si dhe me afatin brenda të cilit mund t’i ushtrojë këto të drejta.
6. Në datën 14.11.2019, përmes postës elektronike, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi të drejtën për të sjellë prova për të provuar të kundërtën e barrës së provës brenda datës 24.11.2019.
7. Znj. Iliriana Olldashi ka paraqitur provat dhe shpjegimet e saj brenda datës 24.11.2019, pas administrimit të të cilave në datën 27.11.2019 trupi gjykues, me vendimin nr. 3, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, znj. Iliriana Olldashi, në seancën dëgjimore në datën 2.12.2019, ora 14:30, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë.

SEANCA DËGJIMORE

8. Në datën 2.12.2019 u zhvillua seanca dëgjimore në prezencë të subjektit të rivlerësimit, znj. Iliriana Olldashi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier, në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
9. Subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht në seancë. Në përfundim të seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë. Seanca dëgjimore e datës 2.12.2019 u ndërpre, për të vazhduar në datën 4.12.2019, me shpalljen e vendimit të trupit gjykues.

QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

10. Subjekti i rivlerësimit, znj. Iliriana Olldashi, ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit ndaj saj, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas nenit 48, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin

kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ. Subjekti ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur. Ka qenë korrekte dhe e gatshme për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

11. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në Aneksin e Kushtetutës, Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016.

VLERËSIMI I PASURISË

12. Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit (ILDKPKI) ka kryer kontroll të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Iliriana Olldashi, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar në përfundim të të cilit ka konstatuar se për subjektin e rivlerësimit, znj. Iliriana Olldashi:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

RIVLERËSIMI I PASURISË

13. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting” si dhe provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI; (b) deklaratat vjetore të pasurisë, si dhe provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI; (c) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (ç) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (d) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik; (dh) shpjegimet me shkrim dhe provat e depozituara nga subjekti i rivlerësimit.
14. Deklarata e pasurisë së subjektit të rivlerësimit iu nënshtrua një hetimi administrativ të thelluar, i cili konsistonte në verifikimin e vërtetësisë dhe saktësisë së deklaratimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit në lidhje me gjendjen pasurore, burimet e krijimit, të ardhurat, shpenzimet, nëse ka konflikt interesi, fshehje të pasurisë apo deklarim të rremë, si dhe përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me çështjen. Pas hetimit administrativ të zhvilluar nga Komisioni, rezultoi si vijon:
Apartament banimi, me nr. 162, me sip. të përgjithshme 91.6 m², ndodhur në pallatin “****” të kompleksit të banimit ***, në Rr. “****”, Tiranë. Prenotuar në datën 5.6.2015, me kontratën e sipërmarrjes nr. ***, me vlerë 65.212 euro.
15. **Burimi i krijimit** deklaruar në deklaratën “Vetting”: (i) të ardhura në vlerën 52.996 euro nga kalimi i të drejtave të sipërmarrjes mbi apartamentin me sip. 77.5 m², me kontratën ***, datë 19.12.2015 (derdhur në llogarinë bankare të firmës ndërtuese “****” sh.p.k.); (ii) të ardhura në

vlerën 10.000 euro kursime nga puna e subjektit dhe e bashkëshortit; (iii) të ardhurat në vlerën 2.212 euro nga kontrata e huasë nr. ***, datë 19.9.2006.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

16. Me kontratën e sipërmarrjes me nr. ***, datë 5.6.2015, subjekti dhe bashkëshorti i saj kanë porositur pranë shoqërisë sipërmarrëse “****” sh.p.k., apartamentin me nr. 162 me sip. të përgjithshme 91.6 m², ndodhur në Rr. “****”, Tiranë, në vlerën 66.000 euro.
17. Me vërtetimin nr. *** prot., datë 24.1.2017, shoqëria sipërmarrëse “****” sh.p.k., informon Komisionin se është paguar vlera 65.212 euro për blerjen e këtij apartamenti.
18. Nga verifikimi i pagesave, lidhur me shlyerjen e çmimit të apartamentit, evidentohen pagesat e mëposhtme:
 - pagesë *cash* në datën e lidhjes së kontratës, më 8.6.2015, në shumën 1.000 euro – pagesë kështu apartamenti;
 - pagesë kështu i parë, në vlerën 21.000 euro, më 30.6.2015, në “Raiffeisen Bank”, për shoqërinë “****” sh.p.k.;
 - pagesë kështu i dytë, në vlerën 11.000 euro, më 18.11.2015, në “Raiffeisen Bank”, për shoqërinë “****” sh.p.k.;
 - transferim të vlerës 20.000 euro, më 20.11.2015, në “Tirana Bank”, për shoqërinë “****” sh.p.k.;
 - pagesë në vlerën 6.000 euro, më 5.4.2016, në “Raiffeisen Bank”, për shoqërinë e ndërtimit “****” sh.p.k.;
 - pagesë në vlerën 4.000 euro, më 26.4.2016, në “Raiffeisen Bank”, për shoqërinë “****” sh.p.k.;
 - pagesë në vlerën 2.212 euro, më 29.9.2016, në “Raiffeisen Bank”, për shoqërinë “****” sh.p.k.

Nga transaksionet konfirmohet shlyerja e vlerës 65.212 euro, me një diferencë prej 788 euro nga vlera e përcaktuar në kontratën e sipërmarrjes, ku është përcaktuar shuma 66.000 euro. Subjekti është pyetur lidhur me këtë diferencë në pagesë dhe ka sqaruar se diferenca e papaguar prej 788 euro përkon me ndryshime që janë realizuar në apartament, duke depozituar vërtetimin datë 27.7.2019, të shoqërisë “****” sh.p.k. Kjo diferencë, në shumën e paguar, është konsideruar nga Komisioni në kuptim të analizës financiare lidhur me porositjen e kësaj pasurie.

Burimi i krijimit të pasurisë: të ardhurat nga kontrata e kalimit të të drejtave me nr. ***, datë 19.12.2015.

19. Burim krijimi për këtë apartament janë të ardhurat e përfituara nga kontrata e kalimit të të drejtave me nr. ***, datë 19.12.2015, nëpërmjet të cilës subjekti i kaloi të drejtat e posedimit mbi apartamentin me sip. 77.5 m², nr. *** “****”, shtetasve A. O. (nëna e subjektit), Ç. O. (babai i subjektit) dhe T. O. (vëllai i subjektit) në cilësinë e “përfituesve”, me miratimin e shoqërisë “****” sh.p.k. (shoqërisë sipërmarrëse), kundrejt vlerës 52.996 euro, vlerë e cila është paguar nga familjarët në “Raiffeisen Bank” dhe “Tirana Bank”.
20. Nga lëvizjet e llogarive bankare, në “Raiffeisen Bank” rezultojnë disa transferta bankare: dy transferta nga babai i subjektit, në total në shumën 31.996 euro, si dhe një transfertë në “Tirana Bank”, në datën 19.11.2015, nga vëllai i subjektit, z. T. O., në vlerën 21.000 euro. Në total këto transferta janë në vlerën 52.996 euro.
21. Nisur nga këto transaksione, të kryera nga babai dhe vëllai i subjektit, bazuar në pikën 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, i është kërkuar subjektit të provojë mundësitë financiare për burimin e

ligjshëm të krijimit të shumave të përfituara nga familjarët e saj, sipas kontratës së kalimit të të drejtave me nr. ***, datë 19.12.2015.

22. Për të provuar mundësitë financiare të prindërve, subjekti ka depozituar kontratën e kalimit të të drejtave me nr. ***, datë 29.3.2013, lidhur midis babait Ç. O. dhe shoqërisë “****” sh.p.k., konfirmuar me transaksionin përfitues – Ç. J. O. në vlerën 26.292 euro, nga kjo marrëdhënie kontraktuale në Bankën Ndërkombëtare Tregtare.
23. Pjesa tjetër e të ardhurave të familjes së subjektit u provua me vërtetimet për të ardhurat e familjareve të saj, të punësuar në marrëdhënie pune me institucione shtetërore që nga momenti i diplomimit të tyre, deri në daljen në pension e aktet përkatëse të lëshuara nga organet kompetente.
24. Për të provuar mundësitë financiare të vëllait, subjekti ka paraqitur dokumentacion ligjor provues për të ardhurat ndër vite të tij, me profesion mjek.
25. Trupi gjykues analizoi shpjegimet dhe provat e sjella nga subjekti i rivlerësimit dhe bazuar në të gjitha provat dhe faktet, arsyeton se:
26. Subjekti ka arritur të provojë me dokumentacion ligjor provues burimet e ligjshme të prindërve e të vëllait, të dhëna subjektit nga familjarët për kalimin e të drejtave të sipërmarrjes mbi apartamentin me sip. 77.5 m².

Burim krijimi për këtë apartament: të ardhura marrë hua shtetases M. M.

27. Nga hetimi rezultoi se në datën 19.9.2016 midis subjektit dhe shtetases M. M. është lidhur para noterit kontrata e huasë me nr. ***, sipas së cilës subjekti ka marrë hua në vlerën 5.000 euro me qëllim pagesën e këstit të fundit dhe mobilimin e apartamentit.
28. Nisur nga kjo marrëdhënie huaje, Komisioni i ka kërkuar subjektit të shpjegojë mbi marrëdhënien e saj me huadhënësen dhe bazuar në pikën 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, të provojë mundësinë financiare për burimin e ligjshëm të krijimit të shumës së dhënë hua.
29. Subjekti, në përgjigjet e pyetësorit të datës 22.7.2019, ka sqaruar Komisionin se shtetasja M. M. është shoqja e saj dhe jeton në Itali në adresën: Rr. “****”, ***, së bashku me bashkëshortin e saj, shtetasin italian D. B. dhe të birin, dhe ka paraqitur dokumentacion ligjor provues për të ardhurat nga puna e saj në shtetin italian, të cilat vetëm gjatë vitit 2016 kanë rezultuar në shumën rreth 9.992 euro.
30. Duke qenë se shtetasja M. M. nuk jeton në Shqipëri, u verifikua në sistemin *TIMS* hyrja në Shqipëri dhe rezultoi se ajo kishte hyrë në datën 16.9.2016 dhe kishte dalë nga Shqipëria në datën 6.10.2016, pra, në datën e nënshkrimit të deklaratës më 19.9.2016, rezultonte se ka qenë në Shqipëri.
31. Lidhur me mënyrën e dhënies së huasë nga hetimi i Komisionit ka rezultuar e provuar se shuma e dhënë hua ka kaluar nëpërmjet llogarisë bankare në “Raiffeisen Bank”, në datë 14.10.2016, në vlerën 4.998,5 euro, nga shtetasja M. M.
32. Trupi gjykues, pasi analizoi dokumentacionin ligjor provues, arrin në përfundimin se subjekti arriti të provojë marrjen e kësaj huaje dhe burimin e ligjshëm të krijimit të të ardhurave të znj. M. M.

Të ardhura nga kursimet si burim krijimi për këtë apartament

33. Në deklaratën “Vetting”, subjekti ka deklaruar si burim krijimi për apartamentin e porositur kursime në vlerën 10.000 euro nga të ardhurat nga puna si gjyqtare në vitet 2006 - 2009 dhe nga viti 2009 të ardhurat nga puna e saj dhe e bashkëshortit.

34. Lidhur me kursimet nga të ardhurat nga pagat, Komisioni verifikoi deklaratat periodike vjetore të dorëzuara ndër vite në ILDKPKI nga subjekti, dhe kreu analizën financiare, bazuar në deklaratën periodike vjetore për vitin 2015, vit ku subjekti kishte deklaruar likuiditete bankare në vlerën 6.000 euro dhe gjendje *cash* 500.000 lekë.
35. Pas kryerjes së analizës financiare për vitin 2015, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës, për një mungesë financiare në vlerën 1.014.010 lekë, në momentin e porositjes së apartamentit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

36. Subjekti, ndër të tjera, shpjegoi se: *“Konfirmoj se në deklaratën periodike vjetore të vitit 2006 e në vijim, kam deklaruar vlerën e kursimeve nga të ardhurat e mia vjetore dhe nga viti 2009 edhe nga të ardhurat e bashkëshortit në gjendje cash gjithsej në fund të vitit 2014 në vlerën totale 1.100.000 (një milion e njëqind mijë) lekë .*

Në datën 30.6.2015, po nga këto kursime nga puna në vite (pra, 2006-2014) në gjendje cash kam depozituar vlerën prej 6.000 euro në “Raiffeisen Bank”, duke u pakësuar gjendja cash me këtë vlerë që shkon 136.450 lekë . Ky fakt është deklaruar në dpv. përkatëse, por nuk është saktësuar prej meje si pakësim i gjendjes cash”.

37. Për mbulimin e shpenzimeve gjatë qëndrimit në Belgjikë, subjekti paraqiti dokumentacion ligjor provues për mbulimin e tyre.
38. Për zërin shpenzime jetike, subjekti pretendoi se në kuptim të zbritjes së tyre duhet të konsiderohen shpenzimet personale të personit të lidhur (bashkëshortit), gjatë periudhës së punësimit për vitet në shoqërinë “***” sh.p.k.

Analiza e fakteve dhe e ligjit të zbatueshëm

39. Në referim të pikës 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, deklarata e pasurisë për vitin 2015 është provë që vërteton pranimin ose rrëzimin e pretendimeve të subjektit në proces.
40. Në analizë të deklaratës periodike të vitit 2015, subjekti ka deklaruar se ka krijuar llogarinë bankare në vlerën 6.000 euro në “Raiffeisen Bank”, por nuk ka përcaktuar si burim krijimi të saj pakësimin e gjendjes *cash* të një viti më parë. Komisioni i jep të njëjtën vlerë ligjore deklarimit të subjektit në deklaratën e vitit 2015 edhe për shumën 500.000 lekë.
41. Trupi gjykues vlerëson se sa është deklaruar nga subjekti se vlera prej 6.000 euro në “Raiffeisen Bank” është krijuar duke u pakësuar gjendja *cash*, por ky fakt nuk është saktësuar si pakësim i gjendjes *cash* në deklaratën periodike vjetore 2015, nuk provohet nga deklarata periodike e subjektit të rivlerësimit në vitin 2015. Pretendimi i subjektit në prapësime se është përdorur gjendja *cash*, por nuk është deklaruar si pakësim, është qartësuar e konsoliduar nga vendimmarrjet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit ku, ndër të tjera, Komisioni orientohet se: për zgjidhjen e çështjeve¹ të ngjashme në të ardhmen ...të mos prezumohet përdorimi nga subjektet i gjendjeve

¹ Vendimi (JR) nr. 7/2019 dhe nr. 11/2019 i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Vendimi (JR) nr. 11/2019, i cili përcakton se: [...] Referuar nenit 4, pika 1, shkronja “d” e të njëjtit ligj, në objektin e deklarimit, sipas kësaj dispozite, përfshihet në konceptin e pasurisë së deklarueshme edhe vlera e likuiditeteve në gjendje *cash*, për të cilat, si për çdo pasuri tjetër, duhet të deklarohet gjendja deri më 31 dhjetor, në raport me deklarimin e mëparshëm mbi të njëjtën pasuri. [...] Gjithashtu, neni 7 i të njëjtit ligj përcakton në mënyrë të shprehur se në deklarimin periodik jepen vetëm ndryshimet e ndodhura në pasuritë, detyrimet financiare dhe interesat privatë të deklaruar më parë, sipas nenit 6 të këtij ligji. Në përputhje me përcaktimet e mësipërme ligjore, janë miratuar edhe modelet e formularëve të deklarimeve periodike, të cilat, në rubrikën e ndryshimeve të pasurive dhe interesave private, në shpjegimet orientuese për subjektet lidhur me mënyrën e deklarimit, udhëzojnë: Përshkruani hollësisht ndryshimet (shesat, pakësimet) [...] të çdo lloj pasurie të paluajtshme dhe të luajtshme, likuiditete, të regjistruar ose jo në regjistrat publikë, për periudhën nga deklarimi i mëparshëm deri më 31 dhjetor të vitit të deklarimit. [...] [...] “25 Para miratimit të përmbajtjes aktuale

cash si burime për krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve, për sa kohë një gjë e tillë nuk është deklaruar në mënyrë të qartë dhe të plotë nga vetë subjekti i rivlerësimit në deklarata periodike [...].

42. Duke iu referuar nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30-33 të ligjit nr. 84/2016, gjatë kryerjes së procedurave të rivlerësimit, objekti i hetimit dhe i vlerësimit të pasurisë ndaj subjekteve që i nënshtrohen këtij procesi, materializohet në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklaramëve të subjektit “Vetting” dhe atyre periodike, si dhe deklaramet e subjektit, mbi faktet e dala gjatë hetimit administrativ. Saktësia dhe mjaftueshmëria e deklaramëve për një subjekt deklarimi vlerësohet vetëm përmes deklaramëve të sakta dhe të plota.
43. Detyrimi ligjor i subjektit të rivlerësimit për të deklaruar pasuritë ka lindur që nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 9049/2003, të ndryshuar, përcaktimet e të cilit kanë qenë të qarta në këtë drejtim, lidhur me deklarimin e çdo pasurie, të paluajtshme, të luajtshme, përfshirë edhe likuiditetet në formën e gjendjes *cash*, si dhe shtesat dhe ndryshimet në to. Për rrjedhojë, marrja në konsideratë e këtij likuiditeti është një argument që nuk mbështetet në ligjin nr. 9043/2003, të ndryshuar, i cili ka parashikuar në mënyrë të qartë detyrimin e çdo subjekti rivlerësimi për të deklaruar çdo shtesë e pakësim të pasurisë **në çdo formë** që ajo ndodh përgjatë një viti periodik.
44. Në lidhje me shpenzimet e qëndrimit në Belgjikë të personit të lidhur, Komisioni i konsideroi në kuptim të rillojaritjes së tyre, për sa subjekti e provoi me dokumentacion ligjor provues qëndrimin dhe shpenzimin.
45. Lidhur me pretendimin e subjektit se në analizën financiare në zërin shpenzime jetike, duhet të konsiderohen në kuptim të zbritjes së tyre shpenzimet personale të personit të lidhur (bashkëshortit), gjatë periudhës së punësimit 2015 – 2016, si ekonomist në shoqërinë “****” sh.p.k., Komisioni vlerëson se subjekti nuk provoi me dokumentacion ligjor lidhur me shpenzimet e personit të lidhur mbuluar prej kësaj shoqërie.
46. Në lidhje me zërin shtesë në likuiditete në vitin 2015, trupi gjykues vendosi të konsiderojë në analizën e kryer se gjendja e likuiditeteve të shtuara në këtë vit nuk është në vlerën 1.298.516 lekë, por është në vlerën 1.022.666 lekë, pasi diferenca e likuiditeteve u provua gjatë hetimit administrativ se është pjesë e të ardhurave të dhëna subjektit, gjatë atij viti kalendarik nga i vëllai për kontratën e kalimit të të drejtave të datës 19.12.2015.
47. Në përfundim, pas analizimit të shpjegimeve të subjektit, si dhe dokumentacionit provues, rezultati financiar për vitin 2015, ndryshoi si më poshtë:

Analiza financiare për vitin 2015	Rezultate hetimi	Analiza finale
PASURI	3,088,517	2,704,199
Kaluar të drejtat familjes së subjektit për apartamentin (52.996 euro)	-7,294,899	-7,294,899
Pronotim ap. me sip. 91.6 m ² , kont. nr. ***, datë 5.6.2015 (65.212 euro)	9,084,900	8,976,432
Shtesa/Pakësime të likuiditeteve	1,298,516	1,022,666

të këtij neni, me miratimin e ligjit nr. 85/2012” “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003”, ky detyrim ligjor përcaktohej shprehimisht në të njëjtën mënyrë nga neni 15, pika 7 e ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”. [...] Faqe 19 nga 20.

DETYRIME	1,651,917	1,651,917
Detyrim ndaj shoqërisë së ndërtimit “****” sh.p.k. (12.212 euro)	1,651,917	1,651,917
TË ARDHURA	1,734,988	1,734,988
Paga e subjektit	1,434,988	1,434,988
Paga e bashkëshortit	300,000	300,000
SHPENZIME	1,312,399	1,285,557
Shlyerje e kësteve të kredisë	284,527	284,527
Pagesë për shkollën jopublike "Reze drite"	71,578	71,578
Shpenzime jetike	897,104	897,104
Shpenzime udhëtimi jashtë vendit	59,190	32,348
REZULTATI FINANCIAR	-1,014,010	-602,850

49. Trupi gjykues arriti në përfundimin se për vitin 2015 me të ardhurat e ligjshme për të cilat janë paguar detyrimet tatimore, sipas përcaktimit të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, subjekti nuk ka pasur mundësi për të përballuar shpenzimet jetike e shpenzime të tjera, si dhe për të kryer shpenzimet për porositjen e apartamentit, duke rezultuar me një bilanc negativ **prej 602.850 lekësh**.
50. Trupi gjykues çmon se mungesa e likuiditeteve gjatë vitit 2015, pas analizës financiare të përditësuar në vlerën prej **-602,850 lekësh**, nuk është në masën që të përbëjë shkak për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit.

Në lidhje me apartamentin me sip. 77.5 m² si burim i deklaruar

51. Komisioni hetoi edhe për burimet e përdorura për pagesën e apartamentit të porositur me kontratën e sipërmarrjes te firma “****” sh.p.k., apartament nga i cili subjekti ka përfituar të ardhura në vlerën 52.996 euro nga kalimi i të drejtave të sipërmarrjes me kontratën ***, datë 19.12.2015.
52. Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2006, subjekti ka deklaruar: *“Tërheqje e kredisë në shtator të vitit 2006 nga Raiffeisen Bank derdhur te shoqëria “****” sh.p.k., për prenotimin e banesës; kursime nga të ardhurat nga paga e të gjitha viteve në shumën 800.000 lekë, të cilat i ka përdorur për të shlyer një pjesë të detyrimit prej 14.000 euro ndaj shoqërisë “****” sh.p.k., si dhe detyrim ndaj prindërve të saj në shumën 1.000.000 lekë për shlyerjen e detyrimit ndaj shoqërisë sipërmarrëse”*.
53. Lidhur me konfirmimin e shlyerjes së çmimit sipas kontratës, modalitetet e shlyerjes, si dhe për të konfirmuar marrëdhëniet e lindura mes shoqërisë së ndërtimit, subjektit dhe familjarëve të saj i është kërkuar informacion shoqërisë sipërmarrëse. Me shkresën e datës 3.8.2019, shoqëria “****” sh.p.k., informon dhe vë në dispozicion aktet lidhur me marrëdhëniet kontraktuale të lartpërmendura, si dhe lidhur me çmimin e paguar. Komisioni i administroi këto akte dhe konstatoi të njëjtat marrëdhënie midis subjektit, personave të lidhur lartpërmendur dhe shoqërisë “****” sh.p.k. Lidhur me pagesën e çmimit, rezultoi e provuar se kësti i parë prej 14.000 euro është paguar nga subjekti përpara redaktimit të kontratës së sipërmarrjes datë 4.8.2006, sikurse ishte përcaktuar në të, në datat e mëposhtme:
- Shuma 2.500 euro, datë 2.6.2006 (sipas mandatarkëtimit nr. ***).
 - Shuma 2.500 euro, datë 28.6.2006 (sipas mandatarkëtimit nr. ***).

- Shuma 1.500 euro, datë 11.7.2006 (sipas mandatarkëtimit nr. ***).
- Shuma 2.500 euro, datë 24.7.2006 (sipas mandatarkëtimit nr. ***).
- Shuma 5.000 euro, datë 3.8.2006 (sipas mandatarkëtimit nr. ***).

54. Për pjesën tjetër të çmimit është paguar shuma 38.500 euro, datë 10.12.2006, me xhirim nëpërmjet “Raiffeisen Bank” dhe diferenca prej 3.000 euro është paguar në datën 13.5.2008 (mandatarkëtimi nr. ***, datë 13.5.2008), me të cilin është likuiduar totalisht çmimi i kontratës në vlerën 55.500 euro.

Lidhur me të ardhurat prej 1.000.000 lekësh nga prindërit dhe kursimet prej 800.000 lekësh

55. Për të provuar këtë burim krijimi për këtë pasuri, subjekti ka depozituar në ILDKPKI deklaratën noteriale nr. ***, datë 20.10.2016, sipas së cilës prindërit e subjektit deklarojnë se: “... në muajin gusht 2006 i kanë dhënë vajzës së tyre shumën prej 1.800.000 lekësh për blerjen e një apartamenti në Rr. ****”. Vlera prej 1.000.000 lekësh janë kursime nga të ardhurat e tyre si prindër gjatë viteve, dhe vlera prej 800.000 lekësh kursime nga të ardhurat e subjektit për vitet 1993 – 2006, të cilat administroheshin nga prindërit.

56. Gjatë kësaj periudhe, subjekti ka bashkuar të gjitha të ardhurat nga puna në familje e të gjithë pjesëtarëve, të cilat administroheshin nga babai si kryefamiljar. Në momentin e prenotimit të apartamentit, subjekti i ka kërkuar ndihmë familjes dhe nga i ati i është dorëzuar shuma prej 1.800.000 (një milion e tetëqind mijë) lekë dhe 800.000 (tetëqind mijë) lekë kursyer nga të ardhurat e saj, ndërsa vlera 1.000.000 (një milion lekë) kursime të të ardhurave familjare. Për të provuar të ardhurat e familjarëve, subjekti ka sjellë në cilësinë e provës vërtetimet përkatëse nga sigurimet shoqërore, si dhe akte të tjera që lidheshin me to për të provuar burimin e ligjshëm të krijimit të të ardhurave të të gjithë familjarëve.

57. Komisioni, pasi vlerësoi dokumentacionin e paraqitur nga subjekti për të ardhurat e krijuara nga familjarët e saj, arriti në konkluzionin se subjekti së bashku me familjarët kanë pasur mundësi financiare për krijimin e shumës së dhënë hua subjektit të rivlerësimit.

58. Pavarësisht këtij konkluzioni, për sa u evidentua në deklaratën para Noterit Publik, sipas së cilës prindërit deklarojnë se: “... në muajin gusht 2006 i kemi dhënë vajzës tonë, shumën prej 1.800.000 lekësh për blerjen e një apartamenti në Rr. ****, Tiranë”. Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit, ku nga hetimi kishte rezultuar se huaja e dhënë nga familjarët nuk mund të ishte përdorur për pagesat e porositjes së apartamentit kryer para muajit gusht 2006 (2500 euro (sipas mandatarkëtimit nr. ***, datë 2.6.2006), - 2500 euro (sipas mandatarkëtimit nr. ***, datë 28.6.2006), - 1,500 euro (sipas mandatarkëtimit nr. ***, datë 2.6.2006) dhe 2,500 euro (sipas mandatarkëtimit nr. ***, datë 24.7.2006).

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

59. Në përgjigje të pyetësorit dërguar nga Komisioni, subjekti ndër të tjera ka sqaruar se: “Në deklaratën e bërë nga prindërit e saj është përmendur muaji gusht i vitit 2006, si muaji kur është plotësuar gjithë dorëzimi i kësaj sasive monetare. Ajo ka konfirmuar se nuk ka qenë në pamjaftueshmëri për të kryer pagesat e kështit të parë, pasi familja e saj së bashku me të, ka pasur mundësinë të kursejnë shumën e paguar”.

60. Për të sqaruar deklarimin e prindërve lidhur me dorëzimin e lekëve, subjekti ka bashkëngjitur deklaratë noteriale të babait me nr. ***, datë 24.11.2019, sipas së cilës i ati deklaroi se ia ka

dorëzuar pjesë-pjesë sasinë monetare (ku ka deklaruar se e ka shoqëruar personalisht në muajt qershor, korrik, gusht në çdo pagesë të bërë prej saj).

Analiza e fakteve dhe e ligjit të zbatueshëm

61. Nga të gjitha faktet e prezantuara më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit arriti të shpjegojë dhe të provojë me provat që njeh legjislacioni procedural situatën faktike, si dhe të japë një shpjegim për rrethanat e pretenduara prej saj në aspektin logjik për sa i përket pretendimit se muaji gusht është përmendur nga familjarët si moment i përfundimit të huadhënies.
62. Nga provat e administruara në hetim nuk rezultoi asnjë fakt i dalë që të vërë në dyshim vërtetësinë e kësaj rrethane dhe situatë të shpjeguar nga subjekti.
63. Në konkluzionin për sa më sipër, në referencë të parashikimeve ligjore të nenit 51, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vlerëson se bazuar në provat që disponon, në vlerësimin e çështjes në tërësi dhe në bindjen e brendshme, subjekti ishte bindëse në shpjegimet e saj.

Lidhur me kredinë e butë në vlerën 5.000.000 lekë

64. Në datën 31.8.2006 subjekti ka lidhur kontratën e kredisë nr. ***, me “Raiffeisen Bank” me objekt kreditimin në vlerën 5.000.000 lekë për blerje apartamenti, me normë interesi vjetor 12 %, ku nga kjo normë, subjekti do të paguante 3 % interes mbi shumën, ndërsa pjesa tjetër do të paguhej nga Ministria e Financave, sipas marrëveshjes lidhur midis “Raiffeisen Bank” dhe Ministrisë së Financave nr. *** prot., datë 20.6.2005, për trajtim me strehim të funksionarëve të lartë të shtetit.
65. Ka rezultuar se: subjekti, në kohën e përfitimit të kësaj kredie, ishte emëruar gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, ishte e shkëputur nga trangu familjar dhe nuk kishte banesë tjetër, duke plotësuar kriteret ligjore për përfitimin e kësaj kredie. Gjithashtu, ka rezultuar se subjekti kishte lidhur kontratën e sipërmarrjes nr. ***, datë 4.8.2006, me shoqërinë “****” sh.p.k., një pjesë e çmimit të së cilës do të paguhej me disbursimin e kredisë.
66. Sipas pikës 8 të kësaj VKM-je parashikohej se: *“Ekzekutimi i kredisë bëhej, pasi përfituesi i kredisë të vendosë për bankën me barrë hipotekore banesën e blerë”*. Nisur nga ky konstatim i kushtit kontraktual të kredisë, i janë kërkuar shpjegime subjektit për arsyet e vendosjes në hipotekë të një apartamenti tjetër. Subjekti ka shpjeguar se apartamenti i porositur me kontratën e sipërmarrjes së vitit 2006, për të cilin kishte marrë kredi në vlerën 5.000.000 lekë, në “Raiffeisen Bank”, në momentin e marrjes së kredisë ishte në ndërtim e sipër, i papërfunduar dhe i paregjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme (i pahipotekuar), gjendje në të cilën nuk mund të shërbente për sigurimin e kredisë, prandaj është vendosur në hipotekë një apartament me adresën: Rr: “****”, nr. ***, Tiranë, në pronësi të shtetasve E. dhe R. H. për sigurimin e kredisë. Është pyetur subjekti për marrëdhënien saj me këta shtetas, e cila ka sqaruar se: *“Shtetasi E. Xh. H. është vëllai i nënës së saj, ndërsa shtetasja R. H. H. është bashkëshortja e tij (nusja e dajës)”*. Subjekti ka provuar lidhjet e të dhënave në certifikata familjare të nënës dhe të dajës.
67. Trupi gjykues, pas administrimit dhe analizimit të provave në lidhje me kredinë e butë të përfituar nga subjekti, si dhe kolateralin e hipotekuar për sigurimin e kredisë nuk konstatoi problematika apo dyshime, për hetim të mëtejshëm.

Çështje të tjera të trajtuara gjatë hetimit administrativ

68. Nga verifikimi i deklaratave periodike vjetore, ndër vite, janë evidentuar adresa të ndryshme të deklaruara nga subjekti, si më poshtë: para fillimit të detyrës në vitin 2003 dhe në vijim ka deklaruar

adresën: Rr. “****”, ap. ***, Njësia Administrative nr. ***, Tiranë; për vitin 2009 ka deklaruar adresë tjetër vendqëndrimi: “****”, pallati i ri, k. ***, Tiranë; për vitin 2011 ka deklaruar adresën: Rr. “****”, Njësia Administrative nr. ***, për vitin 2012 ka deklaruar adresën: Njësia Administrative nr. ***, Rr. “****”, p. ***, ap. ***, Tiranë; dhe për vitin 2015 ka deklaruar adresë tjetër vendqëndrimi në adresën: Rr. “****”, banesë private, nr. ***, Tiranë.

69. Subjektit, lidhur me këto adresa, i është kërkuar të japë shpjegime në pyetësor. Subjekti ka sqaruar se banesa e ndodhur në Rr. “****”, ap. ***, Njësia Administrative nr. ***, Tiranë ose Rr. “****”, Njësia Administrative nr. ***, ose Rr: “****”, p. ***, ap. ***, Tiranë, është e njëjta adresë në të cilët ndodhet banesa në emër të shtetasve T. dhe L. D., përkatësisht vjehri dhe vjehrra e motrës së subjektit, ku banon edhe motra e saj me familjen. Subjekti ka sqaruar se këtë banesë e ka pasur me qira me kontratën e qirasë nr. ***, datë 31.7.2000, lidhur mes saj dhe prindërve të bashkëshortit të motrës, të cilën e ka përdorur për t’u bërë banore e qytetit të Tiranës.
70. Subjekti ka sqaruar se kjo kontratë nuk u zbatua për shkak të emërimit të saj në qytetin e Fierit në muajin shtator të atij viti, periudhë pas së cilës ka banuar në qytetin e Beratit. Gjithashtu, ka sqaruar se duke qenë se nuk ka asnjë të drejtë mbi këtë banesë, rrjedhimisht, nuk ka kryer asnjë shpenzim për të.
71. Adresa tjetër e vendqëndrimit në: “****”, pallati i ri, k. ***, Tiranë, është pikërisht banesa e prenotuar me kontratën e sipërmarrjes te firma “**** “sh.p.k. , ose Rr. “****”.
72. Për të provuar këto sqarime, subjekti ka sjellë në cilësinë e provës, vërtetimin e Njesisë Administrative nr. ***, me nr. *** prot., datë 24.7.2019 dhe kopjen e kontratës së qirasë nr. ***, datë 31.7.2000. Komisioni, pasi administroi vërtetimin e njesisë bashkiake, konstatoi se adresa e deklaruar në Rr. “****” është e njëjta adresë me Rr. “****”, ndërsa adresa në Rr. “****”, banesë private nr. ***, është banesa e prindërve të bashkëshortit të subjektit.
- Për apartament banimi nr. ***, garsoniere, me sip. 44 m², ndodhur në Rr. “****”, deklaruar nga subjekti në përdorim pa kundërshtëpërbllim.**
73. Në deklaratën “Vetting” subjekti ka deklaruar të drejta përdorimi mbi këtë pasuri, e cila është në pronësi të shtetasit I. M., ortak dhe administrator i shoqërisë “****”. Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2016, subjekti e ka deklaruar këtë pasuri si adresë vendqëndrimi tjetër.
74. Nisur nga ky deklaram, Komisioni e ka pyetur subjektin e rivlerësimit lidhur me marrëdhënien me këtë shtetas, mbi shpenzimet e kryera për këtë pasuri, si dhe mbi arsyet e deklaramit si adresë vendqëndrimi tjetër, në kushtet kur në deklaratën periodike vjetore të vitit 2016, adresa e plotë e regjistruar në gjendjen civile ka qenë adresa e apartamentit të subjektit e trajtuar më lart.
75. Subjekti ka sqaruar ndër të tjera se: *“Unë dhe familja ime (bashkëshorti dhe dy fëmijët) kemi filluar të banojmë në apartamentin tonë me nr. *** të ndodhur në Rr. “****”, Tiranë në muajin qershor të vitit 2017...Arsyeja e shënimit të kësaj adrese në dpv e vitit 2016 dhe deklaratën e rivlerësimit lidhet me faktin e përdorimit të saj gjatë këtyre periudhave dhe zhvendosjen e arredimit të saj e sendeve personale tonat, nga garsoniera në banesën e re”* .
76. Apartamenti i banimit nr. ***, i llojit garsoniere, i ndodhur në Rr. “****”, është në pronësi të shtetasit I. D. M., i cili i është dhënë për përdorim vetjak nipit të tij, pra, bashkëshortit të subjektit, z. E. V. M., pa kundërshtëpërbllim në vitin 2007. Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2009, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar kredi konsumatore në vlerën 650.000 lekë, datë 2.10.2007, për 3 vjet, me interes 18 %, me gjendje detyrimi 245.000 lekë. Është pyetur subjekti nëse kjo kredi është shlyer nga bashkëshorti.

77. Subjekti ka sqaruar se: “Kjo kredi është shlyer totalisht në datën 2.10.2010”.

78. Komisioni, pasi administroi shpjegimet çmon se subjekti arriti të provojë shpjegimet e saj mbi adresat e ndryshme të deklaruara nga subjekti, ne deklaratat periodike vjetore, ndër vite.

Lidhur me pasurinë autoveturë tip “Rover”, viti i prodhimit 1996, me targa *, në përdorim**

79. Subjekti ka deklaruar në deklaratën “Vetting” se: “Automjeti është në përdorim pa kundërshpërblim dhe se ky automjet është në pronësi të shtetasit I.T. D. (bashkëshorti i motrës sime B.)”. Lidhur me këtë deklaram të subjektit, ILDKPKI-ja, pas hetimit lidhur me përdorimin mbi këtë automjet, ka konkluduar se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar, si dhe me përgjigjen e ardhur nga DPSHTRR-ja.

80. Nga verifikimi që kreu Komisioni në Regjistrin e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare lidhur me verifikimin e të drejtave të përdorimit, konfirmohet se bashkëshorti i subjektit ka pasur të drejta përdorimi mbi këtë automjet në periudhën 20.12.2015 – 19.12.2016.

81. Është pyetur subjekti nëse ka pasur shpenzime gjatë përdorimit të këtij automjeti, e cila ka sqaruar se: “Automjetin tip ‘Rover’, viti i prodhimit 1996, me targa ***, në pronësi të bashkëshortit të motrës sime e kemi mbajtur vetëm në periudhën muaji prill i vitit 2016 deri në datën 31.10.2017 (kur kemi blerë automjetin tonë)”.

82. Lidhur me këtë pasuri, pas kryerjes së hetimit nga Komisioni dhe analizimit të shpjegimeve të subjektit, trupi gjykues konkludon se deklaratimet e subjektit përputhen me dokumentacionin e administruar gjatë hetimit administrativ.

Konkluzion mbi vlerësimin e pasurisë

83. Trupi gjykues, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, rekomandimet e relatorit të çështjes, pasi dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, mori në shqyrtim pretendimet e parashtruara dhe provat e paraqitura, arriti në përfundimin se në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë, subjekti i rivlerësimit, ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë dhe nuk ka cenuar besimin e publikut.

84. Mungesa e likuiditeteve në vitin 2015, pas analizës financiare të përditësuar në vlerën prej **-602,850 lekësh**, nuk është në masën që të përbëjë shkak për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, duke u parë kjo në raport me një tablo të plotë të qasjes së subjektit të rivlerësimit me deklaramin me vërtetësi e saktësi të pasurive.

85. Mungesa e likuiditeteve për këtë vit nuk ka ndikuar në sjelljen e subjektit të rivlerësimit në drejtim të deklaramin të pasurive në përputhje me detyrimet ligjore, që subjekti i rivlerësimit ka pasur për të bërë ndër vite, në zbatim të legjislacionit që ka rregulluar deklaramin e pasurive dhe konfliktin e interesit të subjekteve të rivlerësimit.

VLERËSIMI I FIGURËS

86. Drejtorja e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklaramimeve dhe të të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuar në nenin DH, të Aneksit të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja, ka dërguar raportin përfundimtar mbi kontrollin e figurës me shkresën nr. 558 prot., datë 4.3.2019, deklasifikuar plotësisht me vendim të KDZH-së nr. ***, datë 1.3.2019, sipas të cilit ka rezultuar se:

87. Formulari i deklaramentit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016.
88. Subjekti i rivlerësimit ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara në deklaratën për kontrollin e figurës. Për subjektin e rivlerësimit nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ose persona të dyshuar të krimit të organizuar. Për sa më sipër, subjekti i rivlerësimit është e përshtatshme për vazhdimin e detyrës.

Konkluzioni për kontrollin e figurës

89. Në përfundim të procesit të rivlerësimit të figurës, bazuar në nenin DH, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në nenin 39, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, znj. Iliriana Olldashi, ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklaramentit për kontrollin e figurës, dhe nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar. Komisioni arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit, znj. Iliriana Olldashi, është e përshtatshme për vijimin e ushtrimit të detyrës.

VLERËSIMI PROFESIONAL

90. Vlerësimi i aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit është kryer në bazë të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, kreut VI, nenit 40 dhe vijuesit të tij, si dhe mbi bazën e kriterëve të përcaktuar në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nga organi kompetent, Këshilli i Lartë Gjyqësor, sipas një raporti të hollësishëm.
91. Raporti për analizën e aftësive profesionale kryer nga Këshilli i Lartë Gjyqësor është bazuar në: formularin e vetëdeklaramentit; tri dokumentet ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit; të dhënat dhe dokumentet e tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklaramentit dhe që janë paraqitur nga subjekti i rivlerësimit; si dhe pesë dosje gjyqësore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor.
92. Të dhënat nga burimet arkivore të KLGJ-së – analiza e gjetjeve i referohet të dhënave të nxjerra nga tri grupet e burimeve të informacionit: (i) formularit të vetëvlerësimit dhe dokumentacionit të paraqitur nga vetë subjekti; (ii) pesë dosjeve të vëzhguara të përzgjedhura me short; dhe (iii) të dhënat nga burimet arkivore të KLGJ-së.

Aftësitë profesionale

93. Subjekti i rivlerësimit, znj. Iliriana Olldashi, ka aftësi të mira në drejtim të interpretimit dhe të zbatimit të ligjit. Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara është konstatuar se, në përgjithësi, subjekti identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret.
94. Nga tri vendimet e përzgjedhura nga vetë subjekti dhe pesë dosjet e përzgjedhura me short del se subjekti, përgjithësisht, i njeh parimet e përgjithshme të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, i zbaton ato në praktikë dhe i bën pjesë të vendimeve gjyqësore shprehimisht. Në çështjet e trajtuara ka të dhëna për njohjen dhe zbatimin e të drejtës ndërkombëtare, Konventën e OKB-së kundër krimit të organizuar ndërkombëtar.

95. Gjyqtarja Iliriana Olldashi, në përgjithësi, bën lidhjen e pjesës së përgjithshme me atë të posaçme të Kodit Penal, duke identifikuar rastin kur vepra penale është kryer në bashkëpunim, kur vepra penale nuk është përfunduar dhe ka mbetur në tentativë si dhe njeh kriteret e individualizimit të masave të dënimit.
96. Nga tri vendimet e përzgjedhura nga vetë subjekti dhe pesë dosjet e vëzhguara, tri prej tyre nuk janë ankimuar në gjykatat më të larta. Në katër raste, vendimet janë ankimuar dhe janë lënë në fuqi nga gjykatat më të larta, ndërsa në një rast vendimi është ndryshuar, duke aplikuar nenin 59 të Kodit Penal.

Arsyetimi ligjor

97. Subjekti i rivlerësimit, znj. Iliriana Olldashi, i harton vendimet përgjithësisht me strukturë të standardizuar. Vendimet përfundimtare të saj respektojnë kërkesat e ligjit procedural penal. Përmbajtja e vendimit, përgjithësisht, është gjithëpërfshirëse dhe i jepet përgjigje pretendimeve të palëve. Në përgjithësi, në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtarja dhe përgjithësisht analiza ligjore është e thelluar, duke paraqitur normën penale të zbatueshme dhe duke dhënë arsyet pse ajo zbatohet në rastin konkret.
98. Në vendimet e subjektit Iliriana Olldashi ka referencë në jurisprudencën e unifikuar të Gjykatës së Lartë, kryesisht për gjykimin e shkurtuar. Në rastin e deklaramit fajtor të të pandehurit, individualizon llojin e masës e dënimit, duke zbatuar dispozitën penale që parashikon veprën e kryer, rrezikshmërinë shoqërore të veprës dhe autorit, shkallën e fajësisë, rrethanat lehtësuese të pranishme, etj. Subjekti, përgjithësisht, i kushton rëndësinë e duhur arsyetimit të vendimeve të ndërmjetme, duke referuar në dispozitën përkatëse. Niveli i arsyetimit të vendimeve ligjore të vëzhguara, përgjithësisht, respekton standardin e procesit të rregullt ligjor.

Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

99. Subjekti i rivlerësimit, znj. Iliriana Olldashi, në periudhën e rivlerësimit, ka kryer detyrën e gjyqtarës të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda. Sipas të dhënave statistikore të përcjella nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, për efekte të organizimit të shortit, konstatohet se për periudhën e rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016, gjyqtarja Iliriana Olldashi, ka përfunduar gjithsej 257 çështje gjyqësore, nga të cilat 240 çështje penale dhe 17 çështje civile (*antimafia*).
100. Sipas shkronja “f”, të pikës 3, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit, në aspektin sasior, gjyqtari i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, duhet të jetë në cilësinë e relatorit në jo më pak se 10 gjykime çështjesh penale në vit dhe për gjithë periudhën e rivlerësimit 30 çështje penale themeli si relator. Duke iu referuar të dhënave të deklaruara prej saj, konstatohet se gjatë periudhës së rivlerësimit ka gjykuar 35 çështje penale themeli si relator, që përbën 116.6% të standardit sasior.
101. Në tri dokumentet e përzgjedhura nga subjekti dhe pesë dosjet e vëzhguara është konstatuar se është respektuar afati kohor i përcaktuar shkronja “f”, në pikën 5, të Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit, apo afatit të parashikuar në nenin 248/1 i Kodit të Procedurës Penale dhe neni 23/2, i ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.
102. Lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimeve gjyqësore nga vëzhgimi i pesë dosjeve të shortuara është konstatuar se, gjyqtarja Iliriana Olldashi, përgjithësisht, i kushton rëndësi

arsyetimit në kohë të vendimeve. Duke konsideruar të dhënat e mësipërme, konstatohet se gjyqtarja Iliriana Olldashi, ka aftësi për të përballuar ngarkesën në punë.

Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

103. Subjekti i rivlerësimit, znj. Iliriana Olldashi, ka aftësi të mira për planifikimin dhe organizimin e veprimeve të nevojshme dhe përgatitjen e çështjeve për gjykim, në funksion të zgjidhjes së çështjeve. Në të pesta çështjet gjyqësore ka marrë masat për planifikimin e seancës gjyqësore në kohën e duhur, duke respektuar edhe të drejtën e palëve për t'u përgatitur për gjykim.
104. Gjyqtarja Iliriana Olldashi, përgjithësisht, ka planifikuar dhe ka zbatuar me korrektesë veprimet e duhura procedurale për zhvillimin dhe përfundimin e gjykimit në një afat të arsyeshëm kohor. Kështu, në një dosje të vëzhguar për verifikimin e kushteve të zbatimit të masës së sigurimit “arrest në burg” (seanca për marrjen në pyetje të personit të arrestuar), ka përfunduar me 1 seancë gjyqësore, e cila ka qenë produktive, ndërsa numri i seancave në çështjet e themelit ka qenë i ndryshëm. Kështu, dosja 1 ka përfunduar me 10 seanca nga të cilat 3 seanca kanë qenë produktive dhe 7 seanca joproduktive, nga të cilat 5 për mungesë të të pandehurit e mbrojtësit dhe 2 seanca për mungesë të prokurorit.
105. Subjekti i rivlerësimit, znj. Iliriana Olldashi, gjatë gjykimit penal identifikon veprimet procedurale që duhen kryer dhe nxjerr urdhra dhe vendime të ndërmjetme për realizimin e tyre. Zhvillon sipas ligjit procedurën e gjykimit gjatë drejtimit të procesit gjyqësor, që nga çelja e seancës, tek kërkesat paraprake të palëve dhe pretendimet e tyre, administrimi i provave, diskutimi përfundimtar gjër tek shpallja e vendimit. Në një rast që ka të bëjë me verifikimin e kushteve të zbatimit të masës së arrestit kjo procedurë nuk është ndjekur e plotë.

Aftësia për të administruar dosjet:

106. Nga vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short u konstatua se ato kanë qenë të rregullta, të sakta dhe të plota. Në dosje janë përfshirë rregullisht vendimi për caktimin e seancës gjyqësore, aktet e njoftimit, procesverbali i seancës gjyqësore, kërkesat me shkrim të palëve dhe aktet shkresore të paraqitura prej tyre, si dhe vendimi gjyqësor. Aktet e prodhuara nga gjykata janë të rregullta nga ana formale. Në dy raste procesverbali gjyqësor ka pasaktësi në pasqyrimin e prezencës së palëve. Në katër dosjet penale vërehet se procesverbali është nënshkruar në fund të çdo flete vetëm nga sekretarja gjyqësore, por jo nga gjyqtarja, duke mos respektuar kështu pikën 2, të nenit 345, të Kodit të Procedurës Penale. Në procesverbal dokumentohet saktësisht, ora e fillimit dhe ora e mbarimit të seancës. Në çdo dosje të vëzhguar ndodhet 1 kopje e vendimit gjyqësor, hartuar me kompjuter, nënshkruar rregullisht në çdo faqe nga kryesuesi dhe në faqet ku është pasqyruar dispozitivi i vendimit dhe në fund të vendimit nga të gjithë anëtarët e trupit gjykues dhe kryesuesi. Aktet në 5 dosjet e vëzhguara janë sistemuar në mënyrë kronologjike në referencë të rregullave procedurale, duke u bërë lehtësisht të shfrytëzueshme për palët. Fashikulli penal në të pesë dosjet e vëzhguara është i inventarizuar nga sekretarja gjyqësore.

Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale:

107. Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, gjatë periudhës së rivlerësimit “8 tetor 2013 – 8 tetor 2016”, për gjyqtaren Iliriana Olldashi është paraqitur një ankesë në vitin 2014. Ankesa e paraqitur në vitin 2014 e verifikuar në lidhje me vendimet e cenuara i është regjistruar gjyqtares për vlerësim profesional dhe etik. Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, për

gjqqtaren Iliriana Olldashi, përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim disiplinor dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

Integriteti

108. Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, znj. Iliriana Olldashi, dhe nga pesë dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

Paanësia

109. Nga tri dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit, znj. Iliriana Olldashi dhe nga pesë dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit. Në pesë dosjet e vëzhguara nuk ka pasur kërkesa për përjashtimin të saj nga gjykimi i çështjeve. Në një rast gjykimi lidhet me të pandehur të mitur, ku i janë garantuar të drejtat e të pandehurit për të pasur mbrojtës dhe njëkohësisht praninë dhe asistencën e një psikologu. Nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit. Po ashtu, nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit nuk ka respektuar rregullat procedurale, me pasojë cenimin e parimit të gjykatës së paanshme.

Aftësitë e komunikimit

110. Në pesë dosjet gjyqësore të vëzhguara, në procesverbalin gjyqësor është konstatuar se gjyqtarja Iliriana Olldashi komunikon me etikë me palët ndërgjyqëse në seancat gjyqësore. Në rastin, kur i drejtohet të tretëve me shkresa, komunikimi është i qartë dhe i sjellshëm.

Aftësia për të bashkëpunuar

111. Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit të rivlerësimit, znj. Iliriana Olldashi, për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta. Rezultoi se në të gjitha rastet ku subjekti i rivlerësimit ka qenë pjesë e një trupi gjykues të formuar nga pesë gjyqtarë, ka bashkëpunuar me ta dhe me administratën gjyqësore për të zhvilluar seancën sipas rregullave procedurale. Në rastet kur shkak për fillimin me vonesë të seancave gjyqësore është bërë një nga anëtarët e trupit gjykues, nuk ka të dhëna për mungesë bashkëpunimi nga kryesuesi, pasi vonesa ka ardhur për shkak se gjykimi ku ata ishin ka zgjatur tej parashikimit të bërë. Edhe në rastet kur gjykimi është shtyrë për mungesë të anëtarit të trupit gjykues, shkaqet janë për arsye shëndetësore. Po ashtu, në 4 dosje nuk janë konstatuar vonesa në arsyetimin e vendimit dhe depozitimin e dosjes gjyqësore në sekretari, ndërsa për një dosje ku është vërejtur vonesë në arsyetimin e vendimit dhe depozitimin e dosjes (shih dosja 1), nuk ka të dhëna se kjo vonesë ka ardhur për shkak të mungesës së bashkëpunimit.

Gatishmëria për t'u angazhuar

112. Subjekti i rivlerësimit, Iliriana Olldashi, për tri vitet e fundit, ka ushtruar detyrën e gjyqtares, i ngarkuar vetëm me çështje penale të krimit të organizuar, terrorizmit dhe korrupsionit, si dhe për sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive. Për shkak të funksionit të gjyqtares së shkallës së parë i nënshtrohet, detyrimisht, programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Në periudhën e rivlerësimit, ajo ka marrë pjesë si pjesëmarrëse në 6 (gjashtë) trajnime pranë Shkollës së Magjistraturës dhe 3 (tre) trajnime jashtë Shkollës së Magjistraturës, në fushën e të drejtës penale, etj.

Konkluzioni për vlerësimin e aftësisë profesionale

113. Trupi gjykues bazuar në: (i) konstatimet e mësipërme dhe argumentet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit; dhe (ii) gjetjet e Këshillit të Lartë Gjyqësor bazuar në kreun II të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pas një analize të bërë në përputhje me ligjin nr. 84/2016, “Për vlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, konkludon se në përfundim të procesit të rivlerësimit të aftësive profesionale, subjekti i rivlerësimit, është vlerësuar “e aftë” profesionalisht.

DENONCIMET

Bazuar në nenin 53, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka analizuar dy denoncimet e ardhura në Komision për subjektin e rivlerësimit: (i) **denoncimin nga shtetasi A. R. Z.**, regjistruar në Komision me nr. *** prot., datë 13.6.2018, i cili referon te pesë anëtarët e një trupi gjykues në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë; dhe (ii) **denoncimin nga shtetasi V. P.**, regjistruar në Komision me nr. *** prot., datë 15.3.2019, i cili referon te disa subjekte, duke përfshirë edhe subjektin e rivlerësimit. Komisioni, pasi administroi dhe analizoi denoncimet e mësipërme, nuk gjeti indicie për fillimin e hetimeve të mëtejshme në kuptim të nenit 53, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, znj. Iliriana Oldashi, ka plotësuar kushtet e mëposhtme:

- a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të germës “a”, pikës 1, të nenit 58, si dhe pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Iliriana Oldashi, gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 4.12.2019.

ANËTARËT E TRUPIT GJKUES

Pamela Qirko
Kryesuese

Xhensila PINE
Relatore

Etleda Çiftja
Anëtare

Etmonda Hoxha
Sekretare gjyqësore